



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3797/ prot.

Pogradec, më 18.09, 2023

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola KAMOLLI KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar znj. Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

**“NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PËR VITIN USHTRIMOR 2023-2024 SIPAS
LIGJIT NR. 22/2018 ME DISA NDRYSHIME ME LIGJIN NR. 48/2023 DATE 22.06.2023”**

Me respekt,

KRYETARI


Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____ .2023

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË _____ .2023

**“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PËR VITIN USHTRIMOR 2023-2024 SIPAS
LIGJIT NR. 22/2018 ME DISA NDRYSHIME ME LIGJIN NR. 48/2023 DATE 22.06.2023”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 2, pika 51 dhe nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

KËSHILLI BASHKIAK



1. Pranë Bashkisë së Pogradecit ngrihet dhe funksionon Komisioni i Strehimit.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, çështjet sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.

3. Komisioni i Strehimit përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

1) Nënkyetar i Bashkisë Pogradec	(Paskalino Ziko)	Kryetar
2) Drejtor i Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokave Bujqësore në Njësitë Administrative	(Besmira Niko)	Anëtar
3) Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale	(Ivana Llakmani)	Anëtar
4) Përfaqësues i Shoqatës së Invalidëve	(Dritan Balliu)	Anëtar
5) Përfaqësues i Komuniteteve të Interesuara (Rome/Egjiptiane)	(Shpëtim Dute)	Anëtar
6) Anëtar i Këshillit Bashkiak	(Ahmed Guxholli)	Anëtar
7) Anëtar i Këshillit Bashkiak	(Vjollca Pllaha)	Anëtar

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (Sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”).

KRYETARE
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT DHE
ADMINISTRIMI I TOKËS BUJQËSORE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2023

RELACION

“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PËR VITIN USHTRIMOR 2023-2024 SIPAS
LIGJIT NR. 22/2018 ME DISA NDRYSHIME ME LIGJIN NR. 48/2023 DATE 22.06.2023”

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma "n" e Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; në zbatim të Ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, neni 2, pika 51; VKM nr. 384, datë 12.06.2019 “Per percaktimin e dokumentacionit për të përfituar Strehim sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimin nga organet e Vetëqeverisjes Vendore”, u krye përzgjedhja e pjesëtarëve të Komisionit të Strehimit Social për vitin ushtrimor 2023-2024, në shqyrtimin dhe vendimarrjet që do kryeje në lidhje me kërkesat që do të paraqiten nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, çështjet sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.

Konceptoi: K. Liçkollari & E.Balliu

Pranues: A. Berberi

Miratoi: B. Niko

Konfirmoi:

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI